



Republic of North Macedonia

Ministry of Health



World Health
Organization

European Region



Funded by
the European Union

ÇDO DOZË VLEN: ÛDHËZUES PËR SËMUNDJE QË MUND TË PARANDALOHEN DHE PËR VAKSINIMIN

“Momenti i duhur është i rëndësishëm” -
Ndiqeni orarin, kompensojeni dozën që nuk e
keni marrë sa më shpejt që të jetë e mundshme.



**ÇDO DOZË VLEN:
UDHËZUES PËR SËMUNDJE
QË MUND TË PARANDALOHEN
DHE PËR VAKSINIMIN**

“Momenti i duhur është i rëndësishëm” -

Ndiqueni orarin, kompensojeni dozën që nuk e

keni marrë sa më shpejt që të jetë e mundshme.

A. Hyrja

Imunizimi është një nga sukseset më të mëdha në historinë e mjekësisë dhe një nga investimet më të rëndësishme shëndetësore në shëndetin publik. Imunizimi çdo vit parandalon miliona raste vdekjesh nga sëmundjet siç janë difteria, tetanusi, pertusis, kolla e mirë dhe fruthi.

Lija është çrrënjosur në mbarë botën, poliomieliti (paraliza e fëmijëve) është afër zhdukjes dhe ka vetëm vetëm një lloj i virusit të egër (tipi 1) që ende ekziston dhe është endemik vetëm në dy vende, shumë të tjera janë afër eliminimit ose janë vënë nën kontroll, kurse rastet janë të rralla ose të regjistruara vetëm në zona të caktuara të botës.

Vaksinimi është masa e vetme parandaluese që është në dispozicion për sëmundjet për të cilat nuk ka kurë të njohur. Përveç kësaj, vaksinimi kundër infeksioneve bakteriale shërben si një mjet për të reduktuar varësinë ndaj antibiotikëve dhe për të pakësuar paraqitjen e rezistencës antibakteriale. Përveç kësaj, me vaksinimin, parandalimi i infeksioneve akute mund të jetë edhe mjet efektiv për të ndaluar zhvillimin e sëmundjeve më serioze dhe potencialisht vdekjeprurëse, sidomos ato të shkaktuara nga disa viruse që dihet se mund të shkaktojnë kancer.

Autoritetet shëndetësore në çdo vend e përcaktojnë kalendarin kombëtar për imunizim në bazë të epidemiologjisë së sëmundjes, me këshilla nga grupet kombëtare këshilldhënëse teknike të imunizimit dhe duke marrë parasysh rekomandimet globale të OBSH-së për vaksinat dhe programet e imunizimit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, imunizimi aktiv filloi nga mesi i shekullit të kaluar, ndonëse me kalimin e kohës numri i sëmundjeve që parandalohen me vaksinim rritej vazhdimisht. Që atëherë, janë kyçur vaksinat kundër shumë sëmundjeve infektive.

Në përputhje me rekomandimet e OBSH-së, në 20 vitet e fundit, Maqedonia e Veriut futi vaksinën kundër hepatitit B (në vitin 2004), vaksinën kundër Haemophilus influenzae tip B (në vitin 2008), si dhe vaksinën kundër Human papilloma virus (në vitin 2009). Vaksinat kundër rotavirusit dhe pneumokokut u vendosën gjithashtu në Kalendarin nacional të imunizimit në vitin 2019.

Vaksinimi është falas për të gjithë personat e moshës 0-18 vjeç në vend, pa marrë parasysh nga sigurimet shëndetësore. Në Maqedoninë e Veriut, imunoprofilaksa dhe kemioprofilaksa e detyrueshme janë rregulluar ligjërisht me Ligjin për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet infektive ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/04, 139/08, 99/09, 149/2014, 150/15 dhe 37/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 257/20) dhe Rregulloren për imunoprofilaksën, kimioprofilaksën, (që përkufizon) personat që u nënshtrohen këtyre masave, mënyrën e kryerjes dhe mbajtjes së evidencës dhe dokumentimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 177/15).

Kalendari i vaksinimit për vitin 2025 në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Vaksina	Mosha / klasa ose viti	Pas Lindjes	Muajt					Klasa në shkollën fillore / mosha				Viti në shkollën e mesme / mosha
	0	2	4	6	12	18	I	II	VII	IX	IV	
							6 vjet	7 vjet	12 vjet	14 vjet	18 vjet	
BCG Tuberkulozi	BCG											
HepB Hepatiti B	HepB	HepB		HepB								
Hib Infeksione me Haemophilus influenzae tip B		Hib	Hib	Hib		Hib						
Rota Infeksione me virusin rota		Rota	Rota	Rota								
PCV Infeksione me pneumokokë		PCV	PCV		PCV							
DTaP Difteria, tetanus, pertusis		DTaP	DTaP	DTaP		DTaP		DTaP				
dT Difteria dhe tetanus										dT		
IPV Poliomieliti		IPV	IPV	IPV		IPV		IPV		IPV		
MMR Fruthi, rubeola dhe shytat					MRP		MRP					
HPV Human papilloma virus									HPV			
TT Tetanus											TT	

Kalendari për plotësimin e vaksinimeve të pakryera për vitin 2025 në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Vaksina.	Moshë / klasa ose viti	Klasa në shkollën fillore/mosha					Viti në shkollën e mesme / mosha
			I	II	VII	IX	IV
		5 vjet	6 vjet	7 vjet	12 vjet	14 vjet	18 vjet
BCG Tuberkulozi							
HepB Hepatiti B							
DTaP Difteria, tetanus, pertusis				DTaP			
dT Difteria dhe tetanus						dT	
IPV Poliomieliti				IPV		IPV	
MMR Fruthi, rubeola dhe shytat			MRP				
HPV Human papilloma virus					HPV		

B. SËMUNDJE TË CILAT MUND TË PARANDALOHEH ME VAKSINA

1. Difteria

Difteria është sëmundje ngjitëse serioze që shkaktohet nga bakteri i quajtur *Corynebacterium diphtheriae*. Bakteri prodhon një substancë të rrezikshme të quajtur toksinë e cila mund t'i dëmtojë indet e trupit të njeriut. Sëmundja përhapet lehtë nga personi i infektuar (ose dikush që mbart bakteret, por nuk ka simptoma) nëpërmjet kollës dhe teshtimës. Difteria mund të transmetohet edhe nëpërmjet sendeve ose ushqimeve të kontaminuara. Shenjat dhe simptomat e sëmundjes zakonisht fillojnë dy deri në pesë ditë pasi infektohet personi.

Pasi bakteri sulmon trupin, toksinat e prodhuara nga bakteri mund të shpërnda-hen nëpërmjet qarkullimit të gjakut dhe të shkaktojnë vështirësi në frymëmarrje, dëmtim të zemrës, veshkave, sistemit nervor dhe madje edhe vdekje.

Sëmundja është fatale në 5-10% të rasteve, kurse te fëmijët deri në moshën 5 vjeç mund të arrijë shkallë të vdekshmërisë prej 20%.

Shenja dhe simptoma të difterisë mund të jenë:

- dhimbje në fyt dhe ngjirje e zërit
- gëlltitje e përcjellur me dhimbje
- gjëndra të ënjtura (gjëndra limfatike të zmadhuara) të qafës
- paraqitja e një membrane të trashë, e bardhë në gri që mbështjell fytin dhe bajamet
- vështirësi në frymëmarrje ose frymëmarrje e shpejtë
- rritje e temperaturës së trupit dhe ethe.

Difteria mund të parandalohet me vaksinë. Kontrolli efektiv i sëmundjes mund të sigurohet nga mbulimi i lartë me vaksinim, me dhënie të tri dozave të vak-sinës së difterisë për të gjithë fëmijët nën moshën një vjeçare.

Doza e parë e vaksinës në Maqedoninë e Veriut u jepet fëmijëve në moshën 60 ditëshe (dy muajsh), dhe më pas në distancë prej minimum katër javësh për dozën e dytë dhe të tretë të vaksinës. Rivaksinimi i parë bëhet në moshën 18 muajshe, kurse rivaksinimi i dytë dhe i tretë bëhet, në moshën 7 dhe 14 vjeç, përkatësisht.

Vaksina kundër difterisë është toksoid i cili gjendet në kombinime të ndryshme me vak-sina të tjera. Vaksina kundër difterisë është e sigurt, efikase dhe tolero-het mirë.

2. Kolla e mirë (Pertusis)

Kolla e mirë ose pertusis është infeksion respirator shumë ngjitës i shkaktuar nga bakteri *Bordetella pertussis*. Kolla e mirë transmetohet lehtë nga personi në person nëpërmjet kollës ose teshtimës, por edhe duke përdorur sende personale të kontaminuara, enë për të ngrënë etj.

Çdokush mund ta fitojë këtë sëmundje në cilëndo moshë, por fëmijët e vegjël janë më të ndjeshëm, veçanërisht foshnjat nën moshën një vjeçare të cilët gjithashtu kanë rrezik më të lartë për të pësuar komplikime serioze, hospitalizim dhe vdekje.

Simptomat e para të sëmundjes shfaqen 7-10 ditë pas infektimit.

Pneumonia (ndezja e mushkërive) është ndërlikimi më i shpeshtë i sëmundjes.

Kolla e mirë më shpesh është fatale për foshnjat nën moshën 6 muajshe se çdo grup moshe tjetër.

Simptomat shfaqen një deri në tri javë pas infektimit. Në fillim, simptomat janë zakonisht të lehta dhe i ngjajnë një rrufe. Pas një ose dy javësh, shenjat dhe simptomat përkeqësohen. Brenda rrugëve të frymëmarrjes grumbullohet një lëng i trashë (mukus), që shkakton kollë të pakontrollueshme. Sulmet e rënda dhe të gjata të kollës mund të shkaktojnë:

- vjellje
- fytyrë të skuqur ose të mavijosur
- lodhje ekstreme
- brinjë të thyera (për shkak të sulmeve ekstreme të kollitjes)
- tingull karakteristik i "ngjirjes së zërit" në fund të sulmeve të kollës, i ndjekur nga një frymëmarrje e thellë për shkak të së cilës sëmundja njihet gjerësisht si "kollë e mirë ose kollë gomari".

Mbrojtja më e mirë kundër kollës së mirë arrihet me vaksinim. Seria primare e vaksinimit kryhet me tri doza të vaksinës. Doza e parë e vaksinës në Maqedoninë e Veriut u jepet fëmijëve në moshën 60 ditëshe (dy muajsh), kurse mandej në distancë prej të paktën katër javësh për dozën e dytë dhe të tretë të vaksinës. Sipas Kalendarit nacional të imunizimit rivaksinimi i parë bëhet në moshën 18 muajshe, kurse rivaksinimi i dytë bëhet, në moshën 7 vjeç.

Vaksinimi kundër kollës së mirë në moshën e rekomanduar te foshnjat e redukon rrezikun e shfaqjes së formës serioze të sëmundjes.

3. Tetanus

Tetanus është sëmundje vdekjeprurëse që merret nga ekspozimi ndaj sporeve të bakterit *Clostridium tetani*, të cilët jetojnë në tokë, pështymë, pluhur dhe pleh organik. Sporet e bakteve mund të hyjnë në trupin e njeriut nëpërmjet plagëve të lëkurës si prerjet, pickimet, djegiet dhe kafshimet e kafshëve. Kur sporet hyjnë në trup, ato zhvillohen në baktere që prodhojnë toksinën e tetanusit që çon në paraqitjen e ngërçeve të dhimbshme të muskujve, veçanërisht në muskujt e nofullës dhe qafës. Ngurtësia e muskujve më vonë përgjithësohet.

Deri në 20% të rasteve të tetanusit mund të përfundojnë me vdekje.

Për dallim nga sëmundjet e tjera të parandalueshme me vaksina, tetanus nuk transmetohet nga personi në person. Sëmundja nuk mund të zhduket për shkak të shpërndarjes së gjerë të bakterit në natyrë.

Nga hyrja e sporeve të tetanusit në trup deri në shfaqjen e simptomave të para, mund të kalojë nga një ditë deri në disa muaj. Shenjat dhe simptomat e zakonshme të tetanusit shfaqen sipas rendit të mëposhtëm:

- ngërçe dhe ngurrje e muskujve të nofullës
- ngurrje e muskujve të qafës
- vështirësi në përthypje dhe gjëlltitje
- ngurrje e muskujve të barkut
- ngërçe të dhimbshme në të gjithë trupin që zgjasin disa minuta, zakonisht të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm: zhurma, drita ose prekja.

Vaksinimi është mënyra më efikase për parandalimin e tetanusit.

Sipas Kalendarit nacional të imunizimit, seria primare e vaksinimit kryhet me tri doza të vaksinës. Doza e parë e vaksinës u jepet fëmijëve në moshën 60 ditëshe (dy muajsh), kurse më pas të paktën me katër javë diferencë për dozën e dytë dhe të tretë të vaksinës. Bëhen katër rivaksinime: në moshën 18 muajshe, në moshën 7 dhe 14 vjeç dhe doza e fundit jepet në moshën 18 vjeç, pra në vitin e fundit të arsimit të mesëm.

Vaksina e tetanusit përmban toksoid tetanusit (anatoksinë). Vaksina gjendet më shpesh për përdorim në kombinim me vaksinën e difterisë dhe kollës së mirë, qoftë individualisht ose si pjesë e vaksinave polivalente.

4. Tuberkulozi

Tuberkulozi është sëmundje e shkaktuar nga bakteri *Mycobacterium tuberculosis*. Bakteri i sulmon zakonisht mushkëritë por mund t'i prekë edhe organet e tjera, siç janë veshkat, kockat dhe shtylla kurizore ose truri.

Edhe pse kjo sëmundje mund të parandalohet dhe të mjekohet me sukses, gjithsej 1,6 milionë njerëz në botë kanë vdekur nga tuberkulozi në vitin 2021. Tuberkulozi është shkaku i dytë kryesor që shkakton vdekje pas KOVID-19.

Tuberkulozi kalon nga një person te tjetri më shpesh nëpërmjet ajrit. Bakteret e tuberkulozit përhapen në ajër kur ndonjë person i infektuar me tuberkulozin e mushkërive kollitet, teshtin ose flet. Një person nëpërmjet frymëmarrjes duhet të thithë vetëm disa prej këtyre baktereve që të infektohet.

Tuberkulozi i mushkërive mund t'i shkaktojë këto simptoma:

- kollë
- kollitje e tepërt, që shoqërohet me gjak
- dhimbje në kraharror
- ethe
- djersitje nate
- humbje e oreksit
- humbje në peshë
- dobësi dhe lodhje.

Vaksina e tuberkulozit ekziston prej më shumë se 80 vjetësh. Vaksina ka një efekt të konfirmuar mbrojtës kundër meningjitit tuberkuloz dhe tuberkulozit të shpërndarë te fëmijët. Sipas Kalendarit nacional të imunizimit, ajo u jepet vetëm një herë të porsalindurve para daljes nga materniteti.

5. Sëmundje të shkaktuara nga Haemophilus influenzae Tip “B”

Haemophilus influenzae tip B (Hib) është bakter i cili shkakton infeksione serioze te fëmijët nën moshën 5 vjeç, siç janë meningjiti (infeksioni i cipës së trurit), pneumonia (inflamacioni i mushkërive), epiglottiti (inflamacioni i kërcës së grykës), bakteremia (prania e baktereve në gjak). Sëmundjet e shkaktuara nga Hib mund të shkaktojnë dëmtime të përrjetshme ose vdekje.

Bakteri përhapet kur personi i infektuar kollitet ose teshtin. Bakteri Hib mund të jetojë në hundë dhe fyt dhe të mos shkaktojë sëmundje. Por nëse bakterit depërton në mushkëri ose gjak mund të shkaktojë sëmundje serioze.

Hib shkakton simptoma të ndryshme, në varësi nga fakti se cilin organ e sulmon. Simptomat mund të jenë:

- ethe, dhimbje koke, konfuzion, qafë e mpirë (meningjiti)
- konsumim i dobët i ushqimit dhe lëngjeve (meningjiti te foshnjat)
- ethe me temperaturë të lartë, kollë, ngulfatje dhe dhimbje krahbarori (pneumoni)
- temperaturë e lartë, lodhje ekstreme dhe konfuzion (bakteremia)
- frymëmarrje me vështirësi (epiglossitis).

Vaksinimi është parandalimi më i mirë kundër sëmundjeve serioze të shkaktuara nga Hib. Një person mund të infektohet me këtë bakter disa herë dhe për këtë arsye vaksinimi rekomandohet edhe për personat që kanë pasur më parë infeksion me Hib.

Vaksinimi primar me vaksinën kundër Hib në Maqedoninë e Veriut u jepet fëmijëve në moshë 60 ditëshe në tri doza me një interval prej 1 deri në 3 muaj. Rivaksinimi bëhet në moshën 18 muajsh. Vaksina kundër Hib jepet si vaksinë e vetme ose si pjesë e vaksinave polivalente.

6. Paraliza e fëmijëve (Poliomielitis - Polio)

Poliomieliti është sëmundje virale shumë ngjitëse, e cila i prek më shumë fëmijët nën moshën 5 vjeç. Poliovirusi transmetohet nga personi në person dhe përhapet më shpesh nëpërmjet rrugës fekale-orale, kurse më rrallë nëpërmjet ushqimit ose ujit të kontaminuar. Virus shumohet në zorrë, ku mund ta sulmojë sistemin nervor dhe të shkaktojë paralizë.

Te më pak se 1% e personave të prekur, virusi shkakton paralizë dhe invaliditet të cilat mund të mbeten të përhershme. Nga personat e paralizuar, 5-10% vdesin për shkak të paralizës së muskujve të frymëmarrjes.

Simptomat e para zakonisht shfaqen 7 deri në 10 ditë pas infektimit.

Në shumicën e rasteve poliovirusi kalon pa asnjë lloj simptomash ose me simptoma të lehta dhe zakonisht nuk dallohet. Vetëm një nga katër persona të infektuar zhvillojnë simptoma të ngjashme me rrufën: ethe, dhimbje fyti, lodhje, dhimbje koke, vjellje, dhimbje barku.

Një përqindje e vogël e personave të infektuar do të zhvillojnë simptoma të tjera më serioze:

- meningjit (ndezje të mbështjellësve të trurit) shfaqet te një në 100 persona të infektuar
- paraliza (më shpesh e këmbëve) shfaqet te më pak se 1% e personave të infektuar.

Nuk ekziston trajtim kundër paralizës së fëmijëve. Zhvillimi i vaksinës efikase kundër poliomielitit është një nga zbulimet më të mëdha mjekësore të shekullit njëzet. Kycja e vaksinës kundër poliomielitit çon në zhdukjen e sëmundjes në pjesën më të madhe të botës. Sëmundja ende është endemike vetëm në dy vende, Afganistan dhe Pakistan. Por, derisa të mos ndalet transmetimi i poliovirusit në këto vende, rreziku i hyrjes së virusit në të gjitha vendet e botës është i pranishëm edhe më tutje.

Në Maqedoninë e Veriut, vaksinimi kundër poliomielitit kryhet me vaksinë të çaktivizuar kundër poliomielitit si pjesë e vaksinave polivalente. Sipas Kalendarit nacional të imunizimit, vakcina primare jepet me tri doza. Doza e parë e vaksinës u jepet fëmijëve në moshë prej 60 ditësh (dy muajsh), kurse mandej në distancë prej minimum një deri në tre muaj për dozën e dytë dhe të tretë të vaksinës. Rivaksinimi i parë jepet në moshën 18-muajshe, kurse rivaksinimi i dytë dhe i tretë jepet, në moshën 7 dhe 14 vjeç, përkatësisht.

7. Hepatit B

Hepatit B është infeksion viral i mëlçisë që shkaktohet nga virusi i Hepatitis B (HBV). Infektimi akut mund të kalojë pa simptoma, me simptoma të lehta, kurse në raste të caktuara mund të çojë në gjendje serioze për të cilën nevojitet hospitalizim. Te disa persona, infektimi kalon në gjendje kronike që mund të shkaktojë mosfunksionim ose kancer të mëlçisë e zezë. Gjendja kronike është më e shpeshtë te infektimet e hershme – 90% e fëmijëve të infektuar do të zhvillojnë infeksion kronik.

Sëmundja kalon nga njëri person te tjetri nëpërmjet kontaktit me gjak ose me lëngje trupore. Rreth gjysma e të sëmurëve nuk e dinë se janë të infektuar dhe mund ta përhapin më lehtë sëmundjen.

Mesatarisht, simptomat shfaqen 90 ditë pas ekspozimit ndaj virusit.

Nëse shfaqen simptoma, ato mund të jenë të lehta deri në jashtëzakonisht të rënda, duke përfshirë:

- dhimbje në stomak
- urinë me ngjyrë të errët
- ethe
- mungesë oreksi
- përzierje dhe vjellje
- dobësi dhe lodhje
- verdhëz.

Mënyra më e mirë për parandalimin e hepatitit B është vaksinimi. Vaksina është e sigurt dhe efektive dhe ofron 90 deri në 100% mbrojtje nga hepatiti B.

Në Maqedoninë e Veriut jepen tri doza të vaksinës së hepatitit B, si një vaksinë e vetme ose si pjesë e një vaksine polivalente. Sipas Kalendarit nacional të imunizimit, doza e parë i jepet të porsalindurit brenda 24 orëve të para pas lindjes. Doza e dytë jepet në moshën 2 muajsh, kurse doza e tretë në moshën 6 muajsh.

8. Human papillomavirus (HPV)

Human Papillomavirus (HPV) është virus që më shpesh transmetohet në mënyrë seksuale. Ekzistojnë mbi 40 lloje të HPV-së që mund të shkaktojnë infeksione gjenitale te gratë dhe burrat. Pothuajse të gjithë personat seksualisht aktivë do të infektohen të paktën me një lloj HPV të paktën një herë në jetën e tyre. Disa lloje të HPV-së mund të shkaktojnë lytha gjenitale. Infeksioni me llojet “më të rrezikshme” të virusit mund të çojë në paraqitjen e llojeve të ndryshme të kancerit, si te meshkujt ashtu edhe te femrat.

OBSH-ja vlerëson se çdo vit ka 600.000 raste të reja në botë, kurse 340.000 vdesin nga kanceri në qafën e mitrës.

Shumica e personave me infeksionin HPV nuk shfaqin simptoma, por megjithatë mund ta ngjisin virusin nëpërmjet kontaktit intim dhe aktivitetit seksual me personin e infektuar.

Symptomat e infeksionit me HPV në shumë raste mund të jenë të lehta dhe disa individë të infektuar mund të mos zhvillojnë asnjë lloj simptome. Disa lloje të infeksionit me HPV mund të shkaktojnë lytha gjenitale (rritje të vogla në zonën e gjenitaleve).

Llojet e tjera të infeksionit me HPV mund të bëhen kronike dhe të shkaktojnë ndryshime parakancerogjene që mund të zhvillohen në kancer invaziv të qafës së mitrës te gratë. HPV -ja mund të shkaktojë, gjithashtu, kancer të vulvës, vagjinës, penisit, anusit dhe fytit.

Mënyra më efektive për të parandaluar infeksionin me HPV është nëpërmjet vaksinimit. Vaksina kundër HPV-së është e sigurt dhe efektive dhe mbron nga të gjitha llojet më të zakonshme të HPV-së që shkaktojnë lytha gjenitale dhe kancer. Është mirë që vaksinimi të bëhet përpara nisjes së aktivitetit seksual.

Në përputhje me rregulloret nacionale, vaksinimi kundër HPV-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i detyrueshëm për të gjitha vajzat dhe djemtë në moshën 12-vjeçare, me dy doza të vaksinës që jepen në distancë prej 6 muajsh.

9. Fruthi

Fruthi është një prej sëmundjeve virale respiratore dhe një nga shkaqet kryesore për vdekje të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare në botë. Virusi i fruthit përhapet nëpër ajër, me pika të imta të sekreteve të cilat i krijojnë personat e infektuar kur kolliten, teshtijnë ose flasin. Virusi kalon me lehtësi nga një person te tjetri, madje 90% e personave që kanë qenë në kontakt me të sëmurin do të sëmuren, nëse nuk e kanë kaluar paraprakisht sëmundjen ose nuk kanë qenë të vaksinuar. Virusi mund të mbijetojë në ajër ose në objekte deri në dy orë, që mundëson transmetim indirekt nëpërmjet objekteve të kontaminuara.

Fruthi mund të shkaktojë komplikime serioze, siç janë inflamacioni i veshit të mesëm, pneumoni (inflamacioni i mushkërive), verbim, encefalit (inflamacioni i trurit), madje edhe vdekje, sidomos te fëmijët në moshë nën pesë vjeç dhe te personat me imunitet të dobët.

Sipas OBSH-së, vlerësohet se çdo vit në nivel global regjistrohen më shumë se 140.000 raste vdekjeje që kanë të bëjnë me komplikimet nga fruthi.

Symptomat e para zakonisht në shumicën e rasteve fillojnë të shfaqen 10 deri në 12 ditë pas kontaktit me virusin.

- Sëmundja ffillon me temperaturë të lartë dhe ethe, dhimbje të fytit, kollë të thatë, rrjedhje hundësh, sy të skuqur dhe të përlotur.
- Pas disa ditësh në lëkurë shfaqet një skuqje karakteristike që ffillon në kokë, pas veshëve dhe në fytyrë dhe përhapet në të gjithë trupin "si uji nga dushi". Në brendësi të gojës, skuqja është në formën e njollave të bardha në gri (Koplik).

Mënyra më e mirë për parandalimin e fruthit është nëpërmjet vaksinimit. Vakcina është e sigurt dhe efektive dhe zakonisht jepet në kombinim me vaksinën kundër rubeolës dhe shytave, siç është vakcina MRP.

Vaksinimi kundër fruthit bëhet me dy doza. Doza e parë në Maqedoninë e Veriut jepet pasi fëmija mbush 12 muaj, kurse doza e dytë jepet në moshën gjashtë vjeçare, përkatësisht kur fillon arsimi fillor.

Vaksinimi jo vetëm që mbron nga virusi, por gjithashtu ndihmon edhe në kontrollin dhe parandalimin e epidemive të fruthit.

Midis viteve 2000 dhe 2018, sipas OBSH-së, vaksinimi kundër fruthit parandaloi rreth 20.3 milionë vdekje, duke treguar se vakcina kundër fruthit është një nga masat më të mira të shëndetit publik.

10. Rubeola (Rubela)

Rubeola është infeksion respirator viral që zakonisht shkakton simptoma të lehta te fëmijët, por mund të shkaktojë edhe komplikime serioze shëndetësore te shtatzënat dhe te fetusit i tyre. Nëse gruaja shtatzënë infektohet me virusin e rubeolës, sëmundja mund të shkaktojë abort spontan, foshnjë të vdekur, lindje të parakohshme dhe/ ose defekte të lindura siç janë problemet me zemrën, humbje e dëgjimit dhe të parit, aftësi të kufizuar intelektuale dhe dëmtim të mëlçisë ose shpretkës. Ky grup i problemeve shëndetësore quhet sindromi i rubeolës kongjenitale – SRK.

Virusi mund të përhapet nëpërmjet ajrit, nëpërmjet kollitjes dhe teshtitjes, kurse mund të përhapet dhe ngjitet edhe nga personi i cili nuk ka simptoma të theksuara.

Simptomat e rubeolës janë zakonisht të lehta dhe vërehen me vështirësi. Nëse shfaqen, ato fillojnë dy deri në tri javë pas ekspozimit ndaj virusit dhe zgjasin 2 deri në 3 ditë. Simptomat mund të përfshijnë ethe të lehta, skuqje që fillon në fytyrë dhe përhapet në pjesën tjetër të trupit, rrjedhje të hundës, dhimbje të fytyrës, dhimbje të nyjeve dhe shpesh ënjtje të gjëndrave limfatike.

Mënyra më e mirë për të parandaluar rubeolën është vaksinimi. Vaksina është e sigurt dhe efektive dhe zakonisht jepet në kombinim me vaksinën kundër fruthit dhe shytave, siç është vakcina MRP.

Vaksinimi kundër rubeolës bëhet me dy doza. Doza e parë në Maqedoninë e Veriut jepet pasi fëmija mbush 12 muaj, kurse e dyta jepet në moshën 6-vjeçare, përkatësisht kur fillon arsimi fillor.

11. Shytat

Shytat (parotiti) janë infeksion respirator viral që i kap gjëndrat pështymore që gjenden pas nofullës. Virusi përhapet nëpërmjet pikave të frymëmarrjes kur një person i infektuar kollitet ose teshtin, por gjithashtu mund të transmetohet nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me pështymën e një personi të infektuar. Sëmundja mund të ngjitet edhe nga një person i infektuar që nuk ka simptoma të shytave.

Virusi i sulmon më shpesh fëmijët nga 5 deri në 14 vjeç, por mund të infektohen edhe persona më të moshuar. Zakonisht, infeksioni përcillet me simptoma të lehta, por në raste të caktuara shytat mund të çojnë në komplikime serioze si encefaliti (inflamacion i trurit), meningjiti (inflamacion i cipës së trurit) ose humbje dëgjimi. Një në katër meshkuj të prekur (fëmijë ose të rritur) zhvillon inflamacion dhe ënjtje të dhimbshme të testikujve, të cilat rrallë mund edhe të çojnë në sterilitet.

Disa prej personave të infektuar me shyta nuk kanë simptoma as shenja të sëmundjes ose zhvillojnë vetëm pasqyrë të lehtë klinike. Nëse shfaqen simptomat, ato zakonisht shfaqen 2 deri në 3 javë pas kontaktit me virusin. Simptomat më të shpeshta janë:

- gjëndra pështymore (parotide) të ënjtura, me ndezje dhe të dhimbshme në njërin ose të dyja anët e fytyrës
- ethe
- dhimbje koke
- gjendje shëndetësore e dobët dhe lodhje
- humbje e oreksit
- dhimbje gjatë përtypjes dhe gëlltitjes.

Mënyra më e mirë për të parandaluar shytat është vaksinimi. Vaksina është e sigurt dhe efektive dhe zakonisht jepet në kombinim me vaksinën kundër fruthit dhe rubeolës, siç është vakcina MRP.

Vaksinimi kundër shytave bëhet me dy doza. Doza e parë në Maqedoninë e Veriut jepet pasi fëmija mbush 12 muaj, kurse e dyta jepet në moshën 6-vjeçare, përkatësisht, kur fillon arsimi fillor.

12. Rotavirus

Virusi rota është shkaku më i shpeshtë për diarre serioze te foshnjat dhe fëmijët e vegjël në mbarë botën. Vlerësohet se deri në 95% e fëmijëve në moshë pesëvjeçare të paktën njëherë janë infektuar me virusin rota.

Virusi rota është shumë ngjitës dhe transmetohet lehtë, më shpesh nëpërmjet rrugës fekale-orale, por mund të përhapet edhe nëpërmjet ajrit. Në sipërfaqet e infektuara, lodrat, në ushqim, virusi rota mund të mbijetojë disa orë.

Infeksioni me virusin rota mund të jetë shumë i rrezikshëm dhe kërcënues për jetën te foshnjat dhe fëmijët e vegjël. Dehidrimi (humbja e lëngjeve) është komplikim serioz nga infeksioni për të cilin nevojitet mjekim spitalor.

Simptomat shfaqen 2 ditë pas infektimit dhe përfshijnë:

- diarre të ujshme
- vjellje
- ethe
- dhimbje barku
- humbje e oreksit
- dehidrim.

Mënyra më e mirë për parandalimin e infeksioneve me virusin rota është vaksinimi. Vaksina është shumë efektive dhe parandalon format e rënda të infeksioneve dhe komplikimeve nga virusi rota, duke përfshirë hospitalizimin dhe vdekjen. Vaksinimi kundër infeksionit me virusin rota në Maqedoninë e Veriut u jepet fëmijëve më të mëdhenj se 60 ditë, me tri doza në një largësi prej minimum katër javësh.

13. Infeksione të shkaktuara nga *Streptococcus pneumoniae*

Streptococcus pneumoniae, që njihet si pneumokoku, është bakter që mund të shkaktojë një sërë infeksionesh, nga infeksioni i lehtë i veshit deri te sëmundjet serioze siç janë pneumonia, meningjiti dhe sepsa. Ky bakter gjendet zakonisht në hundë dhe fyt te njerëzit e shëndetshëm, por mund të shkaktojë sëmundje nëse depërton në organet e tjera të trupit.

Pneumokokët përhapen nëpërmjet ajrit, nëpërmjet kollitjes dhe teshtitjes dhe nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me sekretet respiratore nga mbartësit e sëmurë ose të shëndetshëm të pneumokokut.

Vlerësohet se çdo vit rreth një milion fëmijë në mbarë botën vdesin nga sëmundje të pneumokokut.

Pneumokoku mund të shkaktojë inflamacion në pjesë të ndryshme të trupit, duke përfshirë mushkëritë, trurin, gjakun dhe veshin e mesëm.

Simptomat varen nga organi i prekur nga infeksioni me pneumokok. Sëmundja karakterizohet gjithmonë nga temperatura e rritur dhe ethet, kurse simptoma të tjera të mundshme janë:

- pneumonia: kollë, dhimbje kraharori, ngulfatje
- meningjiti: dhimbje koke, ngurrje e qafës, konfuzion, ndjeshmëri ndaj dritës
- sepsë: frymëmarrje dhe puls i shpejtë, konfuzion, kurse ndonjëherë skuqje e lëkurës dhe tension i ulët i gjakut
- infeksion i veshit të mesëm (otitis media): dhimbje dhe rrjedhje nga
- veshi, ndonjëherë humbje dëgjimi.

Mënyra më efektive për parandalimin e infeksioneve pneumokoke është nëpërmjet vaksinimit. Në Maqedoninë e Veriut vaksina kundër pneumokokut u jepet fëmijëve në moshë prej 60 ditësh deri në 5 vjet. Numri i dozave varet nga mosha kur ka filluar vaksinimi.

Përmbajtja e këtij fletëpalosjeje është përgatitur në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe Bashkimit Evropian, për forcimin e qëndrueshmërisë së sistemeve shëndetësore në vendet e Ballkanit Perëndimor, gjatë zbatimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përmbajtja e këtij fletëpalosjeje është nën përgjegjësinë e vetme të OBSh-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të nënkuptojë se pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.